

LIRIA E SHPREHJES



EKZEKUTIMI I
VENDIMEVE TË
GJYKATËS
EVROPIANE
PËR TË
DREJTAT E
NJERIUT

DG1

FLETË TEMATIKE E FAKTEVE

Përkthimi është
bashkë financuar nga
Bashkimi Evropian



Ky përkthim është prodhuar duke përdorur fondet e Programit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022", projekti "Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave në Kosovë" (JUFREX)". Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë që pasqyrojnë mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "©Këshilli i Evropës, viti i botimit". Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Divizionit për Bashkëpunim për Lirinë e Shprehjes.

@ Këshilli i Evropës, Nëntor2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

Prill 2021

**Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.*

LIRIA E SHPREHJES

Këto përmbledhje bëhen nën përgjegjësinë e vetme të Departamentit për Ekzekutimin e Aktgjyqimeve të Gjykatës Evropiane dhe në asnjë mënyrë nuk detyrojnë Komitetin e Ministrave.

1. SIGURIA E GAZETARËVE	3
2. LIRIA E SHTYPIT DHE GAZETARISË	4
3. LIRIA E SHPREHJES DHE MBROJTJA E BURIMEVE GAZETARESKE	7
4. PLURALIZMI MEDIAL DHE LICENCAT E TRANSMETIMIT (RADIO, TV)	9
5. LIRIA E SHPREHJES KOMERCIALE DHE ARTISTIKE	11
6. SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT PËR QËLLIME ZGJEDHORE	12
7. MBROJTJA E REPUTACIONIT DHE TË DREJTAVE TË TË TJERËVE - PROPORCIONALITETI NË ZBATIMIN E LIGJIT DHE SANKSIONEVE	14
7.1 Procedurat penale për shkeljen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve	14
7.2 Kriminalizimi i fyerjes dhe shpifjes.....	16
7.3 Procedurat civile për dëmin në reputacion dhe të drejta të të tjerëve	18
8. LIRIA E SHPREHJES DHE SIGURIA KOMBËTARE, SIGURA PUBLIKE DHE KUNDËR-TERRORIZMI	19
9. MARRJA E INFORMACIONIT DHE LIRIA E SHPREHJES E TË BURGOSURVE NË INSTITUCIONE PENALE	21
INDEKSI I RASTEVE.....	22

Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të Gjykatës Evropiane, liria e shprehjes është një nga themelet thelbësore të një shoqërie demokratike, një nga kushtet parësore për përparimin e saj dhe për zhvillimin e çdo individi. Ajo nuk vlen vetëm për 'informacionin' dhe 'idetë' të cilat merren, vlerësohen në mënyrë të favorshme si jo ofenduese, ose të cilat e lënë dikë indiferent, por edhe për ata që ofendojnë, shokojnë apo shqetësojnë; kjo do të thotë pluralizëm, tolerancë dhe mendjegjerësi, pa të cilën nuk ka "shoqëri demokratike".

Gjykata ka theksuar se liria e shprehjes i nënshtrohet përjashtimeve, por këto duhet të interpretohen ngushtë, pasi nevoja për kufizimin e saj duhet të përcaktohet bindshëm. Mbiemri "i nevojshëm" në nenin 10 § 2 nënkupton "nevojë të ngutshme shoqërore". Kjo dispozitë lë pak hapësirë për kufizime të lirisë së shprehjes në dy fusha: gjuhën politike dhe çështjet me interes publik. Shtetet kontraktuese kanë një margjinë të caktuar vlerësimi për të gjykuar ekzistencën e një nevoje të tillë, por kjo shoqërohet me mbikëqyrjen evropiane si të ligjit ashtu edhe të vendimeve që e zbatojnë atë, edhe kur ato burojnë nga një gjykatë e pavarur.

Kjo fletë faktesh paraqet një numër shembujsh të masave të përgjithshme dhe, kur është e përshtatshme, individuale të miratuara dhe raportuara nga shtetet, në kontekstin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane, për të mbrojtur lirinë e shprehjes, duke përfshirë sigurinë e gazetarëve, lirinë e shtypit dhe mbrojtjen e burimeve gazetareske, pluralizmin mediatik dhe licencat e transmetimit, lirinë e shprehjes komerciale dhe artistike, shpërndarjen e informacionit për qëllime zgjedhore, mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve dhe proporcionalitetin në zbatimin e ligjit dhe sanksioneve, lirinë e shprehjes në kontekstin e sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe antiterrorizmit, dhe marrjen e informacionit nga të burgosurit në institucionet penale

1. SIGURIA E GAZETARËVE

Në vitin 2000, Gjykata Evropiane konstatoi se autoritetet kishin dështuar në mbrojtjen e jetës së bashkëshortit të aplikantit.

Bashkëshorti i aplikantit, një gazetar i njohur për kritikën e tij ndaj pushtetarëve, ishte kërcënuar nga persona të panjohur përpara se të rrëmbehej dhe të gjendej i vdekur. Gjykata gjithashtu konstatoi se nuk kishte asnjë mjet juridik efektiv për zhdukjen dhe vdekjen e gazetarit për më shumë se katër vjet.

Pas vendimit të Gjykatës Evropiane, tre policë u dënuan në vitin 2008 për rrëmbimin dhe vrasjen e gazetarit. Gjithashtu, në vitin 2019 u zhvilluan seancat dëgjimore parlamentare për sigurinë e gazetarëve. Seancat dëgjimore parlamentare rekomanduan krijimin e një mekanizmi kombëtar të reagimit të shpejtë për mbrojtjen e gazetarëve, duke përfshirë një linjë telefonike qeveritare. Modalitetet e një mekanizmi të tillë, duke përfshirë një platformë në internet, u diskutuan në dy ngjarje online në vitin 2020.

Gjithashtu, një projektligj që zgjeron përkufizimin e “gazetarit” dhe rrit përgjegjësinë për shkeljet ndaj gazetarëve u regjistrua në Parlament në vitin 2020. Trajnimi i specializuar për gjyqtarët, prokurorët dhe zyrtarët e policisë për mbrojtjen e gazetarëve është zhvilluar së bashku nga Shkolla Kombëtare e Magjistraturës, Qendra e Trajnimit të Prokurorëve dhe Akademia Kombëtare e Brendshme dhe me mbështetjen e Këshillit të Evropës.

*Ukrainë / Gongadze
(34056/02)*

[Aktgjykimi final më
08/02/2006](#)

[Rezolutë e përkohshme
CM/ResDH\(2009\)74](#)

2. LIRIA E SHTYPIT DHE GAZETARISË

Amendamenti i Kushtetutës për të lehtësuar zbatimin e drejtpërdrejtë nga gjykatat vendase të parimeve të përcaktuara nga Gjykata Evropiane

Norvegji / *Tønsbergs Blad AS*
dhe *Haukom*
(510/04)

Në përgjigje ndaj konstatimeve të Gjykatës Evropiane në këtë rast, në lidhje me një dënim penal privat për shpifje në të cilën aplikantët (shtëpia botuese e gazetës së përditshme rajonale *Tønsberg Blad*) u ndëshkuan për publikimin e artikujve të shtypit në lidhje me një shkelje të pretenduar të kërkesës për qëndrim të përhershëm, autoritetet deklaruan se të dhënat kriminale të aplikantëve nuk përmbanin asnjë referencë për dënimin.

[Aktgjykim final më](#)
[01/06/2007](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2009\)7](#)

Gjithashtu, janë miratuar masa për të lehtësuar zbatimin e drejtpërdrejtë nga gjykatat të parimeve të Gjykatës Evropiane për lirinë e shprehjes. Konventa Evropiane u fut në ligjin norvegjez me Aktin e vitit 1999, i cili thotë se Konventa ka përparësi ndaj ligjit të brendshëm. Në vitin 2004, pas fakteve të këtij rasti, neni i Kushtetutës për lirinë e shprehjes u ndryshua me qëllim që askush nuk mund të mbajë përgjegjësi për komunikimin ose marrjen e informacionit ose ideve në bazë të lirisë së shprehjes, kërkimit të së vërtetës, mbrojtjes së demokracisë dhe lirisë së të gjithë personave për të formuar opinionet e tyre. Sipas autoriteteve, zbatimi i Kushtetutës në dritën e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Evropiane do të sigurojë një ekuilibër të duhur midis të drejtës për lirinë e shprehjes dhe të drejtave të tjera.

Miratimi i një ligji për sqarimin e kushteve për detyrimin për të marrë autorizimin për publikim ose citim

Poloni / *Wizerkaniuk*
(18990/05)

Në lidhje me një dënim penal të një redaktori dhe bashkëpunuar të një gazete lokale për publikimin e një interviste me një deputet vendor pa marrë paraprakisht lejen e tij, një ligj i vitit 2017 ndryshoi dispozitat e kundërshtuara nga Gjykata Evropiane. Ndryshimi më i rëndësishëm është sqarimi i kërkesës për leje publikimi apo citimi.

[Aktgjykim final më](#)
[05/10/2011](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2019\)98](#)

Sipas ligjit, publikimi apo citimi pa leje nuk është më krim, por kundërvajtje me gjobë. Kështu, një gazetar nuk mund të ndëshkohet për publikimin e një deklarate në përputhje të plotë me deklaratën origjinale, edhe nëse ai ose ajo nuk i plotëson plotësisht kërkesat e lejes. Për më tepër, janë ruajtur rregullat që një gazetar nuk mund ta pengojë të intervistuarin të japë leje për shpërndarjen e një deklarate dhe përjashtimi që nuk kërkohet leje nëse deklarata tashmë është publikuar.

Ndryshimi në praktikën gjyqësore vendore drejt një ekuilibri midis lirisë së informacionit dhe opinionit, dhe të drejtës për nder, emër dhe reputacion

Portugali / *Medipress-Sociedade Jornalística e Editorial, Lda* (55442/12)

Pas aktgjykimit të Gjykatës në padinë civile kundër shtëpisë botuese të aplikantit për dëmtim të reputacionit të kryeministrit të atëhershëm si rezultat i publikimit të një artikulli për shtyp në një revistë në pronësi të aplikantit, autoritetet vunë në dukje një zhvillim në praktikën gjyqësore vendore. Ky zhvillim ka të bëjë me ekuilibrin ndërmjet të drejtës për lirinë e informacionit dhe opinionit dhe të drejtës individuale për nder dhe reputacion. Në këtë mënyrë, aktgjykimet e Gjykatës Supreme riprodhojnë konsiderata të marra nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane dhe refuzojnë pretendimet për dëmshpërblim nëse Gjykata Supreme konsideron se artikujt e kundërshtuar të shtypit përbëjnë opinione (gjykime të vlerës) të formuluar në kontekstin e një debati publik të përgjithshëm interesi, duke respektuar kufijtë e kritikës së arsyeshme.

[Aktgjykim final më](#)
[30/11/2016](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2019\)201](#)

Reforma legislative për qasjen në dosjet gjyqësore dhe zbutja e nocionit "fshehtësi".

Për të parandaluar përsëritjen e një shkeljeje të Konventës në lidhje me dënimin e një gazetari me gjobë ose një dënim alternativ prej 86 ditësh burgim për shkelje të "fshehtësisë së hetimit" ose "fshehtësisë së drejtësisë" (*segredo de justiça*), ligji i vitit 2007 ndryshoi Kodin e Procedurës Penale duke autorizuar rishikimin e aktgjykimeve që ishin bërë *res judicata*. Rishikimi mund të kërkohet nga prokurori publik dhe nga personi i dënuar.

Kodi i Procedurës Penale i zbatueshëm gjatë periudhës së fakteve parashikonte se të gjitha palët dhe personat e tjerë që kishin qasje në dosje ishin të detyruar nga *segredo de justiça* për sa kohë që rasti ishte në i pazgjidhur para gjykatësit hetues. Me hyrjen në fuqi të ligjit të vitit 2007, "*segredo de justiça*" nuk zbatohet më automatikisht për periudhën paraprake, por vetëm me vendim të caktuar të marrë nga gjyqtari hetues ose nga prokurori publik nën mbikëqyrjen e gjyqtarit hetues. Autoritetet theksojnë se në praktikë, nuk jepen dënime me burg për shpifje.

Portugali / *Colação Mestre*
dhe *Sociedade*
Independente de
Comunicação
(11182/03+)

[Aktgjykimi final më](#)
[26/07/2007](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2015\)115](#)

Ndryshimi i praktikës gjyqësore për të analizuar dhe balancuar lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e reputacionit

Në përgjigje të konstatimeve të Gjykatës Evropiane mbi balancën ndërmjet të drejtës së një shtëpie botuese (gazetë javore *Mladina*) për lirinë e shprehjes, për shkak të publikimit të një artikulli gazetaresk polemizues dhe të drejtës së një deputeti për mbrojtjen e reputacionit të tij, Gjykata Kushtetuese ndryshoi praktikën gjyqësore me synimin për të vendosur një ekuilibër të drejtë midis dy të drejtave në fjalë. Kështu, në një vendim të vitit 2014 për një rast të ngjashëm, Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të lirisë së shprehjes dhe për këtë arsye ia ktheu rastin gjyqtarit të shkallës së mëparshme në mënyrë që të miratohej një vendim i ri në përputhje me vendimin e Gjykatës Evropiane.

Sloveni / *Mladina*
d.d. *Lubjanë*
(20981/10)

[Aktgjykimi final më](#)
[17/07/2014](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2017\)111](#)

Ndryshime legislative dhe ndryshime në praktikën gjyqësore për sekuestrimin, ndalimin dhe pengimin e publikimeve

Pas vendimit të Gjykatës Evropiane për mbylljen e një gazete për një periudhë 30-ditore, autoritetet bënë me dije se urdhrat për sekuestrimin dhe mbylljen e gazetës ishin revokuar.

Gjithashtu, në vitin 2012 u miratuan ndryshime legislative, duke parashikuar që vendimet e mëparshme për sekuestrimin, ndalimin, pengimin e shpërndarjes dhe shitjes së publikimeve të shtypura u bënë *ipso facto* të pavlefshme. Dispozitat e ligjit për shtypin të vitit 2004, i cili ka hyrë në fuqi pas fakteve të rastit, kërkojnë kritere vlerësimi objektive dhe të paanshme për sekuestrimin e publikimeve dhe duhet të bazohen në një vendim gjyqësor. Gjithashtu, Kodi i Procedurës Penale, i cili u miratua pas fakteve të këtij rasti, parashikon se urdhër-konfiskimi mund të jepet vetëm në rastet e dyshimeve të forta ose të provave konkrete të një krimi.

Për sa i përket praktikës gjyqësore vendore, dhe pas aktgjykimit të Gjykatës, shteti i paditur ka dhënë shembuj konkretë të zbatimit efektiv të ligjit për shtypin nga gjykatat e shkallës së parë.

Turqi / *Saygılı* dhe
Bilgiç (33667/05)

[Aktgjykimi final më](#)
[20/08/2010](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2019\)26](#)

Zhvillimet legjislative për të siguruar zbatimin e së drejtës për lirinë e papenguar të shprehjes

Ukrainë / Grupi i mediave
ukrainase (72713/01)

Për të korigjuar dëmin e shkaktuar nga një dënim civil për shpifje në vitin 2000, pas publikimit të dy artikujve në shtyp që kritikonin kandidatët politikë, autoritetet kanë treguar se legjislacioni për shpifjen u ndryshua me ligjin e vitit 2003. Kështu, një seksion i ri iu shtua ligjit që mundëson përjashtimin e gjykimeve të vlerave nga përgjegjësia. Termi "gjykim i vlerës" përkufizohet si "shprehje që nuk përmbajnë informata faktike" dhe të cilat "nuk mund të provohen apo të hidhen poshtë".

[Aktgjykimi final më
12/10/2005](#)

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2007\)13](#)

Ndryshime të tjera u futën nga një ligj i vitit 2006, sipas të cilit organet shtetërore dhe qeveritë autonome lokale nuk mund të kërkojnë kompensim për dëmin moral për publikimin e informacionit të rremë, megjithëse mund të kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre për përgjigje. Ligji parashikon mbrojtjen e "publikimit në mirëbesim". Si të tillë, gazetarët dhe mediat janë të përjashtuar nga përgjegjësia për publikimin e informacionit të rremë, nëse gjykata vërteton se gazetari ka vepruar në mirëbesim dhe ka verifikuar informacionin. Në këtë kontekst, dëmshpërblimi për dëmin jomaterial mund të vendoset vetëm në rast të qëllimit keqdashës nga ana e gazetarit apo publikimit. Synimi keqdashës përkufizohet si shpërndarje e informacionit të rremë me qëllim të destabilizimit të shoqërisë.

Për më tepër, një nga nenet e ndryshuara në Kodin Civil në vitin 2005 parashikon se një individ që shpërndan informacionin e marrë nga burime zyrtare nuk është i detyruar të verifikojë vërtetësinë e tij dhe nuk mund të mbajë përgjegjësi nëse informacioni përgënjeshtrohet. Megjithatë, informacioni i marrë nga burime zyrtare duhet të shoqërohet me njoftimin e burimit.

3. LIRIA E SHPREHJES DHE MBROJTJA E BURIMEVE GAZETARESKE

Hyrja në fuqi e ligjit për mbrojtjen e burimeve gazetareske

Pas aktgjykimit të Gjykatës për kontrollet e banesave dhe ambienteve të biznesit të aplikantëve, katër gazetarëve dhe dy shoqatave të gazetarëve, disa nga objektet dhe dokumentet që u ishin sekuestruar iu kthyen, ndërsa pjesa tjetër nuk përbënte më interes për ta.

*Belgjikë / Ernst dhe të tjerë
(33400/96)*

[Aktgjykimi final më
15/10/2003](#)

Në vitin 2005, pas fakteve të rastit, u miratua një ligj për mbrojtjen e burimeve gazetareske, i cili ndalon hulumtimin e burimeve të tilla, duke përfshirë kontrollin ose sekuestrimin. Përgjashtimi i vetëm nga ky ndalim parashikohet nga ligji, me kërkesë të gjyqtarit, nëse ato janë të natyrës që parandalojnë kryerjen e veprave që përbëjnë kërcënim serioz për integritetin fizik të një ose më shumë personave dhe nëse informacioni i kërkuar është i një rëndësie vendimtare dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë tjetër.

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2010\)39](#)

Miratimi i ligjit për lirinë e shprehjes në media dhe mbrojtjen e burimeve gazetareske

Për të korrigjuar pasojat negative të shkeljes, dokumenti i sekuestruar gjatë kontrolleve është kthyer dhe hetimi gjyqësor është mbyllur.

*Luksemburg / Roemen
dhe Schmit (51772/99)*

[Aktgjykimi final më
25/05/2003](#)

Ligji për Lirinë e Shprehjes në Media i vitit 2004 përmban një seksion të veçantë për mbrojtjen e burimeve gazetareske, duke theksuar se e drejta për mbrojtje të tillë nuk kufizohet vetëm në rastet kur gazetari është i përfshirë në një procedurë si dëshmitar.

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2011\)127](#)

Për të zgjidhur konfliktin ndërmjet të drejtës për mbrojtjen e burimeve dhe detyrimit për të provuar vërtetësinë e fakteve të pretenduara, në një procedurë penale për shpifje ose në një procedurë civile për dëmtim të nderit ose reputacionit të një personi, ligji parashikon që gazetari mund të shmangë përgjegjësinë ose duke vërtetuar vërtetësinë e pretendimeve ose duke provuar se ishin ndërmarrë hapa të mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se faktet e raportuara ishin të vërteta dhe se publiku kishte një interes mbizotërues për të ditur informacionin në fjalë. Ligji i vitit 2004 synon të sjellë ligjin vendor në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane dhe me Rekomandimin R(2000)7 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi të drejtën e gazetarëve për të mos zbuluar burimet e tyre të informacionit.

Amendamenti legjislativ që jep të drejtën për të refuzuar të dëshmojë dhe të zbulojë burimet e informacionit

Në vitin 2018, për zbatimin e vendimit të Gjykatës, Kodi i Procedurës Penale u ndryshua dhe një nen i ri parashikon të drejtën e refuzimit të dëshmimit ose zbulimit të burimeve të informacionit në kuadër të raportimit profesional apo mbledhjes së informacionit për këtë qëllim.

*Hollandë /
Voskuil
(64752/01)*

[Aktgjykimi final më
22/11/2001](#)

Përveç kësaj, amendamenti i ri u mundëson gazetarëve të refuzojnë të zbatojnë një urdhër për sekuestrimin e materialeve gazetareske nëse urdhri shkel detyrimin e tyre për të ruajtur konfidencialitetin e burimeve. Thirrja e gazetarit në këtë dispozitë mund të refuzohet nga gjyqtari hetues nëse ai ose ajo konsideron se ruajtja e konfidencialitetit do të ishte në mënyrë disproporcionale e dëmshme për një interes më bindës.

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2018\)437](#)

Në këtë rast, sekuestrimi do t'i nënshtrohet vlerësimit paraprak të gjyqtarit hetues dhe nuk varet vetëm nga vlerësimi i hetuesit.

Statuti i ri ligjor që përcakton kufizimet në përdorimin e kompetencave të veçanta nga shërbimet e inteligjencës dhe sigurisë për të identifikuar burimet gazetareske

*Holandë / Telegraaf Media
Nederland Landelijke Media
b.v. dhe të tjerë
(39315/06)*

Meqë Gjykata Evropiane vendosi për shkeljen e lirisë për të marrë dhe për të dhënë informacion për shkak të masave të përgjimit ndaj dy gazetarëve me synimin për t'i detyruar ata të zbulojnë burimet e tyre të informacionit, për të parandaluar përsëritjen e një shkeljeje të Konventës, Ligji i ri për Shërbimet e Inteligjencës dhe Sigurisë hyri në fuqi në vitin 2018.

[Aktgjykimi final më
05/01/2018](#)

Ky ligj parasheh që nëse shërbimet e inteligjencës dhe sigurisë synojnë të përdorin kompetenca të veçanta ndaj gazetarëve për të identifikuar burimet e tyre gazetareske në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ato duhet së pari të marrin miratimin e Gjykatës së Qarkut në Hagë.

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2018\)437](#)

Ndryshim në praktikën gjyqësore për mbrojtjen e burimeve gazetareske

*Norvegji / Becker
(21272/12)*

Gjykata Evropiane konstatoi shkelje në lidhje me një urdhër gjyqësor në lidhje me detyrimin për të dëshmuar në procedurë penale dhe për të zbuluar burime gazetareske. Autoritetet deklaruan se Konventa Evropiane u fut në ligjin norvegjez me Aktin e vitit 1999 i cili thotë se Konventa ka përparësi ndaj ligjit të brendshëm. Parimet e përgjithshme të përcaktuara në aktgjykimet e Gjykatës Evropiane janë burimet kryesore të ligjit kur gjykatat interpretojnë Konventën. Autoritetet kanë deklaruar se kur lindin çështje të barabarta ose të ngjashme para gjykatave vendore, gjykatat do të zbatojnë parimet e përgjithshme të përcaktuara në aktgjykimin e kësaj Gjykate.

[Aktgjykimi final më
22/02/2013](#)

Në një vendim të vitit 2015, Gjykata Supreme u mbështet shumë në jurisprudencën e nenit 10 të Gjykatës edhe përpara vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane. Rasti kishte të bënte edhe me mbrojtjen e burimeve gazetareske. Gjykata Supreme konstatoi në aktgjykimin e saj se Ligji i Procedurës Penale parashikonte mbrojtje "pothuajse absolute" të burimeve gazetareske. Gjykata Supreme konstatoi në aktgjykimin e saj se Ligji i Procedurës Penale parashikonte mbrojtje "pothuajse absolute" të burimeve gazetareske.

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2018\)366](#)

4. PLURALIZMI MEDIAL DHE LICENCAT E TRANSMETIMIT (RADIO, TV)

Amendamenti i Ligjit për Transmetimin e Radiotelevizionit

Armeni / Meltex dhe Mesrop Movsesyan (32283/04)

Pas aktgjykimit të Gjykatës për shkeljen e lirisë së shprehjes së kompanisë së aplikantit për shkak të refuzimit të Komisionit Kombëtar të Transmetimit të Radiotelevizionit (CNTR) për t'i dhënë aplikantit licencë transmetimi ndërmjet viteve 2002 dhe 2003, në vitin 2010 u miratua një ndryshim në Ligjin për Transmetimin. Sipas këtij ligji, vendimet e Komisionit Kombëtar të Transmetimit të Radiotelevizionit (CNTR) merren në bazë të rezultateve të votimit nga anëtarët e tij dhe ky vendim duhet të jetë i motivuar dhe i argumentuar siç duhet. Autoritetet morën përsipër që çdo vendim i CNTR-së do të merrej në përputhje me Konventën Evropiane dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane.

[Aktgjykimi final më 17/09/2008](#)

[Rezolutë finale CM/ResDH\(2011\)39](#)

Gjithashtu, në korrik 2010 është shpallur tender për transmetim digjital në 25 frekuenca kombëtare dhe lokale. Kompania e aplikantit ka marrë pjesë në këtë tender për një frekuencë dhe ka paraqitur ofertën e vet në përputhje me kërkesat e ligjit. Rezultatet e tenderit u shpallën në dhjetor 2010. Kompania e aplikantit mori vendim të arsyetuar nga CNTR-ja dhe kishte mundësinë të kundërshtonte rezultatet e konkursit përpara gjykatave vendore.

Miratimi i ligjit për transmetimet kablore dhe satelitore

Austri / Informationsverein Lentia dhe të tjerët (13914/88)

Në vitin 1997, pas vendimit të Gjykatës Evropiane për mungesën e licencave për funksionimin e stacioneve radiotelevizive, licencimi i transmetimeve private iu transferua Autoritetit Rajonal Radiofonik dhe Kabllor. Ky Autoritet duhet të sigurojë që transmetimet rajonale të mund të merren nga të paktën 70% e popullsisë së një provincë. Përmbajtja e transmetimeve radiofonike rajonale dhe lokale duhet të respektojë parimet e objektivitetit dhe diversitetit të mendimeve, të drejtat themelore të të tjerëve dhe të mos nxisë urrejtje të bazuar në racë, fe, origjinë etnike ose kombësi.

[Aktgjykimi final më 24/11/1993](#)

[Rezolutë finale DH\(98\)142](#)

Përveç kësaj, në vitin 1997 u miratua Ligji për Transmetimin Kabllor dhe Satelitor. Sipas këtij ligji, transmetimi satelitor mund të kryhet me lejen e organit kompetent rajonal si për transmetimin radiofonik ashtu edhe atë kabllor. Licencat u jepen të gjithë aplikantëve që plotësojnë kërkesat zyrtare. Transmetimet duhet të përfaqësojnë në mënyrë adekuate jetën publike, kulturore dhe ekonomike të zonës së mbuluar.

Vendimet në bazë të Ligjit për Transmetimet Rajonale dhe Ligjit për Transmetimet Kabllor dhe Satelitor i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor.

Amendamenti legjislativ për të vendosur rregulla për dhënien ose refuzimin e arsyetuar të licencave dhe shqyrtimin gjyqësor

Bulgari / Glas Nadezhda EOOD dhe Anatoliy Elenkov (14134/02)

Nga viti 2001, pas fakteve të këtij rasti që kishte të bënte me një refuzim të pajustificuar për dhënien e licencës së transmetimit dhe mungesën e shqyrtimit adekuat gjyqësor të këtij vendimi, autoritetet raportuan ndryshime legjislative në fushën e licencave të transmetimit që nga viti 2001 dhe krijimin e Këshillit për Media Elektronike (EMC) i cili rregullon veprimtarinë e radiotelevizionit. Ligji parashikon një procedurë tenderimi për dhënien e licencave për transmetimin analog radioteleviziv dhe një procedurë aplikimi për licencë për transmetimin radioteleviziv digjital tokësor.

[Aktgjykimi final më 11/01/2008](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2019\)335](#)

Për të parën nga këto procedura, EMC vendos, duke dhënë arsyetimin e vendimit, se cilit aplikant duhet t'i jepet licenca në bazë të dokumenteve të ofruara, kriterëve të vlerësimit dhe një vlerësimi kompleks të përputhshmërisë me kërkesat e konkurrencës. Në lidhje me licencat për radiotelevizion digjital, numri i të cilave është i pakufizuar, vendimi për dhënien e licencës bazohet në kriteret e garantimit të së drejtës për marrjen dhe dhënien e informacionit, krijimin e kushteve për diversitetin mediatik, pluralizmin dhe ruajtjen e identitetit kombëtar.

Sistemi i drejtësisë administrative shqyrton plotësisht vlefshmërinë dhe justifikimin e vendimeve të EMC-së, duke përfshirë kompetencën e organit, formën, dhënien, bazat faktike dhe ligjore, përputhjen me rregullat procedurale dhe përputhjen e tij me ligjin kombëtar dhe atë komunitar..

Televizioni digjital dhe kontributi i tij në zbutjen e monopolit në sektorin e transmetimit televiziv

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 10 në lidhje me pamundësinë e një kompanie për t'u angazhuar në sektorin audiovizual (midis viteve 1999 dhe 2009) për shkak të mangësive të kornizës legjislative për të korrigjuar problemin e monopolit në sektorin e transmetimeve televizive dhe për të siguruar pluralizëm efektiv në media.

Së pari, autoritetet theksuan se kompania në fjalë kishte qenë në gjendje të përdorte frekuencat e saj dhe të transmetonte kanalën e saj që nga viti 2009. Për më tepër, korniza legjislative që kishte vendosur një regjim të favorshëm kalimtar për kanalet e tepërta nuk ishte më i zbatueshëm që nga kalimi në televizionin digjital në vitin 2012. Televizioni digjital ka ndryshuar tregun audiovizual, duke hapur derën për një mori operatorësh.

Gjithashtu, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve (AGCOM), i cili është autoritet i pavarur administrativ, ka kompetenca për të rregulluar, kontrolluar dhe sanksionuar mediat audiovizuale, duke garantuar njëkohësisht pluralizmin e informacionit dhe të drejtën për konkurrencë. Që nga viti 2014, një rregullore e re specifikon modalitetet e licencimit, transferimin dhe caktimet e pronësisë së kompanive transmetuese.

*Itali / Centro Europa 7
S.R.L. dhe Di Stefano
(38433/09)*

[Aktgjykimi final më](#)
[07/06/2012](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2017\)104](#)

5. LIRIA E SHPREHJES KOMERCIALE DHE ARTISTIKE

Amendamenti legjislativ për të rregulluar kufizimin e reklamimit duke përdorur simbole fetare *Lituani / Sekmadienis Ltd. (69317/14)*

Për të korrigjuar pasojat e kufizimit joproporcional të lirisë së shprehjes për reklamat që përdorin simbole fetare dhe në përputhje me vendimin e Gjykatës Evropiane, autoritetet informuan se reklamat e kompanisë së aplikantit lejoheshin dhe përdreshin për të promovuar linjën e veshjeve të stilistëve.

[Aktgjykimi final më 30/04/2018](#)

Përveç kësaj, në vitin 2013, Ligji për Reklamën u ndryshua duke hequr kriterin e 'moralit publik' dhe duke përcaktuar se reklamat mund të ndalohen vetëm nëse shprehin përbuzje për simbolet fetare të komuniteteve fetare.

[Rezolutë finale CM/ResDH\(2019\)3](#)

Legjislacioni i ri që vendos rregulla për prezantimet filmike dhe teatrale

Maltë / Unifaun Theatre Productions Limited dhe të tjerët (37326/13)

Pas vendimit të Gjykatës Evropiane, autoritetet treguan se shfaqja, e cila fillimisht ishte e ndaluar të shfaqej, mund të prezantohej përfundimisht në shtator 2018.

Përveç kësaj, ligji i vitit 2015 për 'Filmin dhe Skenën' është ndryshuar në mënyrë që ndalimi i plotë të mos jetë më i mundur dhe shfaqjet teatrale klasifikohen tani sipas kategorisë së moshës, bazuar në *Bordin Drejtues të Teatrit*. Bordi është kompetent të pranojë ankesa nga çdo anëtar i publikut që ndihet i pakënaqur ose i ofenduar nga një krijim dramatik ose teatral. Mund të vendosë të refuzojë kërkesat; të rekomandojë një klasifikim alternativ të moshës; ose të rekomandojë që njoftimet për përmbajtjen të hartohen dhe t'i komunikohen publikut. Nëse një palë e interesuar ndihet e pakënaqur nga vendimi i Komisionit, ai ose ajo mund të ngrejë padi përpara Dhomës së Gjykatës Civile për të kundërshtuar vendimin.

[Aktgjykimi final më 15/08/2018](#)

[Plani i veprimit](#)

[Statusi i përmbartimit: në pritje](#)

6. SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT PËR QËLLIME ZGJEDHORE

Përmirësimi i shpërndarjes së informacionit nga subjektet e vogla politike dhe qasja në një kanal të ri televiziv

Norvegji / TV Vest As dhe Rogaland Pensjonistparti (21132/05)

Gjykata Evropiane konstatoi se një kompani e transmetimit televiziv (TV Vest As) dhe një subjekt politik për pensionistët në pension, Partia Politike e Pensionistëve (*Partia e Pensionistëve Rogaland*) kishin pësuar shkelje të lirisë së shprehjes kur ishin gjobitur nga Autoriteti Kombëtar i Medias për shkelje të legjislacionit që ndalonte transmetimin e reklamave politike. Reklamimi televiziv me pagesë ishte e vetmja mënyrë që partia e vogël të transmetonte mesazhin e saj tek publiku.

[Aktgjykimi final më 11/03/2009](#)

[Raport veprimi](#)

[Rezolutë finale CM/ResDH\(2011\)234](#)

Në vitin 2009, pas vendimit të Gjykatës, autoritetet anuluan gjobën e lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Medias. Përveç kësaj, në vitin 2009 u miratuan ndryshime legjislative që kërkonin që stacioni televiziv kombëtar (NRK) të sigurojë mbulim të gjerë dhe të balancuar zgjedhor dhe të sigurojë që subjektet e vogla politike të përfshihen edhe në mbulimin editorial të NRK-së. Këto parti tani kanë qasje edhe në kanalin e ri televiziv "*Frikanalen*". Kështu, autoritetet kanë vënë në dukje se, në zgjedhjet parlamentare të shtatorit 2009, subjekti politik në këtë rast dhe subjekte të tjera të ngjashme politike janë përfshirë efektivisht në mbulimin zgjedhor të NRK-së dhe "*Frikanalen*".

Përmirësimi i rregullave për publikimin dhe reklamimin gjatë periudhave zgjedhore dhe vendosja e gjobave administrative në vend të dënimeve me burgim

Turqi / Erdoğan Gökçe (31736/04)

Gjykata Evropiane vendosi për shkeljen e lirisë së shprehjes në lidhje me sanksionin penal të një kandidati në zgjedhjet komunale për dhënien e një komunikate për shtyp para periudhës zgjedhore. Si rrjedhojë, autoritetet raportuan se gjykata penale kishte fshirë dënimin nga regjistri penal i kandidatit.

[Aktgjykimi final më 14/01/2015](#)

[Rezolutë finale CM/ResDH\(2017\)92](#)

Shkelja buron nga zbatimi i dispozitave të Ligjit për "Dispozitat Themelore që rregullojnë zgjedhjet dhe regjistrimin e votuesve", i cili i ndalonte kandidatët të bënin fushatë dhjetë ditë para zgjedhjeve. Autoritetet theksuan se ky ligj u ndryshua në vitin 2008, pas ngjarjeve të këtij rasti, duke përcaktuar se sanksionet për mosrespektim të rregullave zgjedhore mund të përfshijnë vetëm gjoba administrative dhe jo më burgim. Në vitin 2010, një amendament vendosi se nuk ka kufizime kohore për fillimin ose përfundimin e fushatës zgjedhore dhe se kandidatët mund të reklamojnë fushatat e tyre zgjedhore përmes televizionit, internetit ose shtypit.

Miratimi i një ligji për kufizimin e shpenzimeve të komunikimit dhe reklamave zgjedhore

*Mbretëri e Bashkuar /
Bowman (24839/94)*

Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 10 në lidhje me një vepër të bazuar në një Akt të vitit 1983, i cili ndalonte një person të paaautorizuar të shpenzonte më shumë se pesë funta (GBP) për ofrimin e informacionit për votuesit për të promovuar ose siguruar zgjedhjen e një kandidati gjatë periudhës parazgjedhore. Kështu, shpenzimi maksimal ishte aq i ulët sa përbënte pengesë për publikimin e informacionit nga aplikanti.

[Aktgjykimi final më
19/02/1998](#)

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2007\)14](#)

Autoritetet i kërkuan 'Komitetit Neill' (organ i pavarur) të shqyrtojë implikimet e vendimit të Gjykatës dhe të shqyrtojë masat e përgjithshme. Rekomandimet çuan në miratimin e një ligji të ri për financimin e partive politike në dhjetor 2000, i cili hyri në fuqi në vitin 2001. Në këtë ligj, kufiri i shpenzimeve, të cilin Gjykata Evropiane e kishte konstatuar si shumë të ulët, u rrit nga 5 në 500 funta për një kandidat në zgjedhjet parlamentare dhe në 50 funta për një kandidat në zgjedhjet lokale.

7. MBROJTJA E REPUTACIONIT DHE TË DREJTAVE TË TË TJERËVE - PROPORCIONALITETI NË ZBATIMIN E LIGJIT DHE SANKSIONEVE

7.1 Procedurat penale për shkeljen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve

Ndryshimet legislative që parashikojnë se fyerja nuk mund të çojë në burgim

*Bullgari / Raichinov
(47579/99)*

Si rezultat i gjobës dhe një qortimi publik për fyerje të një zyrtari të lartë, Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 10 të Konventës. Për të korigjuar pasojat negative, autoritetet kanë treguar se vërejtja publike nuk është zbatuar asnjëherë për shkak të parashkrimit. Për më tepër, pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane, në vitin 2007, Gjykata Supreme e Kasacionit miratoi rihapjen e procedurave penal, anuloi dënimin dhe shpalli pafajësinë. Ajo e bazoi aktgjykimin e tij në gjetjet e Gjykatës Evropiane.

[Aktgjykimi final më
20/07/2006](#)

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2011\)5](#)

Për më tepër, pas ndryshimeve në Kodin Penal të miratuar në vitin 2000, fyerja nuk dënohet më me burgim. Për më tepër, praktika gjyqësore po zhvillohet vazhdimisht në drejtim të marrjes në konsideratë më mirë të Konventës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane.

Praktika gjyqësore që balancon të drejtën e lirisë së shprehjes dhe mbrojtjen e nderit

*Spanjë / Otegi
Mondragon (2034/07)*

Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 10 në lidhje me dënimin me një vit burgim për shpifje të rëndë ndaj Mbretit. Autoritetet treguan se asnjë dënim me heqje lirie nuk ishte vuajtur, ekzekutimi i dënimit ishte pezulluar me një urdhër gjykate të vitit 2006 dhe përmendja e dënimit ishte fshirë nga regjistri penal i aplikantit.

[Aktgjykimi final më
15/09/2011](#)

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2017\)251](#)

Për sa i përket praktikës gjyqësore vendore, në vitin 2015, Gjykata Kushtetuese vendosi që neni për shpifjen në Kodin Penal duhet të zbatohet në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane. Gjykata rikujton nevojën për të vendosur një ekuilibër të duhur midis të drejtës për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjes së nderit. Në të vërtetë, liria e shprehjes duhet të matet në mënyrë adekuate për të përcaktuar nëse ajo shpreh mendim kritik kundër monarkisë dhe mbrojtjes kushtetuese të mbretit, ose, përkundrazi, nëse është një akt që nxit dhunën ose urrejtjen kundër kurorës dhe monarkut.

Zhvillimet e praktikës gjyqësore për kufijtë dhe proporcionalitetin e zbatimit të ligjit penal në rastet e shpifjes

*Spanjë / Rodriguez
Ravelo (48074/10)*

Në përgjigje ndaj konstatimeve të Gjykatës Evropiane, lidhur me dënimin me burgim që mund të shqiptohet në rast të mospagesës së gjobës, nuk ka pasur heqje lirie për shkak se nuk janë zbatuar kurrë masat e parapara të burgimit. Dënimet penale të aplikantit nuk figurojnë më në regjistrin penal dhe kërkesa e dorëzuar për rishikim u pranua.

[Aktgjykimi final më
12/04/2016](#)

[Raport veprimi](#)

[Statusi i përmbartimit: në pritje](#)

Për më tepër, autoritetet treguan se praktika gjyqësore vendore e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme në vitet 2015 dhe 2016 përfshinte parimet, argumentet dhe kriteret e miratuara nga Gjykata Evropiane për mbrojtjen e të drejtës së lirisë së shprehjes.

Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme vlerëson se nuk ka as fyerje e as shpifje kur bëhet fjalë për ushtrimin legjitim të së drejtës për të shprehur dhe shpërndarë lirisht informacione, mendime, ide dhe opinione të vërteta. Kjo Gjykatë ka arritur në përfundimin se ligji penal është një instrument shumë i ashpër dhe se mjetet e tjera juridike mund të jenë më të përshtatshme.

Reforma legislative për shprehjen joshpifëse

Gjykata Evropiane vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 10 në lidhje me një dënim penal joproporcional për shpifje për deklaratat që aplikanti kishte bërë si avokat gjatë një deklarimi. Si rezultat i vendimit të Gjykatës Evropiane, asnjë përmendje e dënimit nuk figuron në regjistrin penal të aplikantit.

Për më tepër, masat legislative u morën në vitin 2000, pas ngjarjeve që shkaktuan këtë rast dhe përpara se Gjykata Evropiane të kishte konstatuar shkelje, për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhmen, veçanërisht me reformën e Kodit Penal me Aktin e vitit 2000. Sipas legjislacionit të ndryshuar, kritika ndaj sjelljes së një personi në ushtrimin e veprimtarive të tij politike ose profesionale, funksioneve ose titujve publikë, veprimtarive shkencore ose artistike, nuk konsiderohet shpifje kur kritika nuk i kalon qartazi kufijtë e sjelljes së pranueshme.

*Finlandë / Nikula
(31611/96)*

[Aktgjykimi final më
21/06/2002](#)

[Rezolutë finale
ResDH\(2006\)51](#)

Shfuqizimi i veprës penale të fyerjes së kreut të shtetit

Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 10 në lidhje me një gjobë të pezulluar ofendim të kreut të shtetit. Për të parandaluar shkelje të ngjashme, autoritetet kanë bërë me dije se ligji i vitit 2013, duke parashikuar dispozita përshtatëse në fushën e drejtësisë në zbatim të ligjit të BE-së, shfuqizoi nenin e ligjit të vitit 1881 që lidhej me veprën penale të fyerjes së kreut të shtetit.

*Francë / Eon
(26118/10)*

[Aktgjykimi final më
14/06/2013](#)

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2014\)10](#)

Ndryshim në praktikën gjyqësore për veprën e publikimit të informacionit për padi civile

Pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për një dënim penal për veprën e "publikimit të informacionit në lidhje me padi civile", dënimi nuk figuron më në regjistrin penal të aplikantit.

Për më tepër, në dy vendime të njëpasnjëshme në vitin 2001, Divizioni Penal i Gjykatës së Kasacionit u shpreh se Akti i vitit 1931, me ndalimin e tij të përgjithshëm dhe absolut, kufizon mbrojtjen e interesave legjitime të renditura në nenin 10 dhe, duke qenë i papajtueshëm me këtë dispozitë, nuk mund të përdoret si bazë për një dënim penal. Autoritetet argumentuan se dispozitat e Aktit të vitit 1931 që ndalonin publikimin e çdo informacioni në lidhje me padi civile përpara një vendimi gjyqësor nuk ishin më efektive në ligjin vendor.

*Francë / Du Roy dhe
Malaurie (34000/96)*

[Aktgjykimi final më
03/01/2001](#)

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2008\)9](#)

Zhvillimet në praktikën gjyqësore që përfshin konceptet dhe kriteret e lirisë së shprehjes të Gjykatës Evropiane në vendimin mbi proporcionalitetin e sanksioneve

Për të ndrequr pasojat negative të shkeljes pas dënimeve penale për shpifje, dy raste u rihapën dhe dënimet u anuluan nga Gjykata e Kasacionit në bazë të vendimeve të Gjykatës Evropiane. Në tri rastet e tjera në të cilat aplikantët nuk kërkuan rihapjen e procedurave penal, megjithatë ata ishin në gjendje të aplikonin për një ndryshim në regjistrat e tyre penale.

*Francë / Jean-Jacques
Morel Group
(25689/10+)*

[Aktgjykimi final më
10/01/2014](#)

Autoritetet kanë krijuar kurse të shumta trajnimi për gjyqtarët mbi lirinë e shprehjes. Praktika gjyqësore e fundit nga Gjykata e Kasacionit tregon një përvetësim më të qartë të kriterëve të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për lirinë e shprehjes për të vlerësuar proporcionalitetin e sanksioneve për deklaratat e bëra. Kështu, në vendimet e dhëna në vitet 2015, 2016 dhe 2017, Gjykata e Kasacionit i referohet dallimit ndërmjet “deklarimeve të fakteve” dhe “gjykimeve të vlerës” dhe nocionit të “debatit me interes të përgjithshëm”. Prandaj, ajo përfshiu në arsyetimin e saj një nga kriteret thelbësore të përdorura nga Gjykata Evropiane për të përcaktuar nëse deklaratat tendencioze ishin pjesë e një debati me interes të përgjithshëm, në mënyrë që të kishte një pikëpamje më të hapur për vërejtjet që mund të bëheshin në këtë kontekst. Gjykata e Kasacionit i shqyrton këto deklarata, duke kontrolluar nëse ato kanë bazë të mjaftueshme faktike dhe se nuk i kalojnë kufijtë e pranueshëm të lirisë së shprehjes. Së fundi, ajo vlerëson se i takon gjyqtarit gjykues të kontrollojë proporcionalitetin e dënimit në dritën e nenit 10.

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2019\)88](#)

Deklarimi i antikushtetutshmërisë së një dispozite ligjore që i ndalon një personi të paditur për shpifje të shfaqësohet nga përgjegjësia për fakte që datojnë më shumë se dhjetë vjet më parë

Francë / Mamère
(12697/03)

Gjykata Evropiane konstatoi se dënimi penal për shpifje për të paguar një gjobë dhe dëmshpërblim ishte në kundërshtim me Konventën. Në vitin 2011, autoritetet treguan se Këshilli Kushtetues deklaroi se dispozita legjislative e vitit 1881 mbi lirinë e shtypit, e cila ndalon një person të ndjekur penalisht për shpifje të shfaqësojë veten nga përgjegjësia kur akuza i referohet fakteve që datojnë më shumë se dhjetë vjet, ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Këshilli Kushtetues specifikoi se kjo shpallje e antikushtetutshmërisë është e zbatueshme për të gjitha pretendimet shpifëse që nuk janë gjykuar përfundimisht në ditën e publikimit të vendimit të tij.

[Aktgjykimi final më](#)
[07/02/2007](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2011\)104](#)

Zhvillimet e praktikave gjyqësore lidhur me nivelin e pranueshëm të kritikave ndaj figurave publike

Serbi / Lepoija dhe
Filipovia (13909/05)

Gjykata Evropiane konstatoi ndërhyrje të pajustificuara në lirinë e shprehjes së aplikantëve, politikanë vendas, të cilët u dënuan në një proces penal për shpifje ose përbuzje, dhe më pas u urdhëruan në procese civile të paguanin dëme të konsiderueshme në kompensim për të njëjtin paditës, një kryetar komune, i cili ishte edhe drejtor i një kompanie shtetërore.

[Aktgjykimi final më](#)
[31/03/2008](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2009\)135](#)

Në vitin 2008, Gjykata Supreme dha opinion ligjor, duke lejuar zbatimin e drejtpërdrejtë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane në ligjin vendor. Në këtë mënyrë, shkalla e kritikës së pranueshme është shumë më e gjerë për figurat publike sesa për individë. Ky opinion është ligjërish i detyrueshëm për të gjitha gjykatat më të ulëta në vend. Autoritetet kanë dhënë gjithashtu informacion mbi një aktgjykim të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë në vitin 2008. Aktgjykimi i referohet nenit 10 të Konventës Evropiane dhe thekson se mbajtësit e funksioneve publike duhet të pranojnë kritikën, edhe nëse ato i tejkalojnë kufijtë e mirësjelljes së zakonshme.

7.2 Kriminalizimi i fyerjes dhe shpifjes

Dekriminalizimi i dënimeve me burg për shpifje

Kroaci / Slava Jurishiq
(79584/12)

Në përgjigje të konstatimeve të Gjykatës Evropiane për shkelje të nenit 10 për shkak të një dënimi penal për shpifje, autoritetet treguan se, për t'i dhënë fund shkeljes, regjistri penal i aplikantit nuk e përmbante më dënimin. Më tej, në vitin 2013, pas fakteve të rastit, u miratua një Kod i ri Penal. Kjo hoqi dënimin me burgim për shpifje dhe për këtë arsye personi i dënuar për shpifje mund të dënohet vetëm me gjobë.

[Aktgjykimi final më](#)
[08/02/2018](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2018\)377](#)

Autoritetet kanë theksuar se ky ndryshim legjislativ është gjithashtu në përputhje me Rezolutën 1577 (2007) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Dekriminalizimi i shpifjes dhe përgjegjësia civile

*Maqedoni /
Makraduli
(64659/11)*

Pas vendimit të Gjykatës Evropiane për dënimet penale për shpifje që përfshinin një zyrtar të lartë shtetëror dhe një politikan, sanksioni penal u hoq nga regjistri penal i aplikantit.

[Aktgjykimi final më](#)
[19/10/2018](#)

Në vitin 2012 është miratuar Ligji për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje, me çka është shfuqizuar shpifja dhe fyerja penale. Dekriminalizimi i shpifjes u krye në përputhje me dokumentet e Këshillit të Evropës, duke përfshirë Rezolutën 1577 të Asamblesë Parlamentare (2007). Ligji ka të bëjë me përgjegjësinë civile për dëmtimin e nderit dhe reputacionit të personave fizikë dhe juridikë, për shkak të fyerjeve ose shpifjeve. Ai parasheh që çdo kufizim në lirinë e shprehjes duhet të jetë në përputhje me Konventën Evropiane dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane. Duke qenë se shpifja nuk është më vepër penale, autoritetet konsiderojnë se kjo masë ka të ngjarë të parandalojë shkelje të ngjashme.

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2019\)190](#)

Dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes penale

*Mal i Zi / Shabanoviq
(5995/06)*

Në përgjigje ndaj konstatimeve të Gjykatës Evropiane për një dënim me burgim me kusht për shpifje kundër një zyrtari publik për përgjigje ndaj pretendimeve për ujë të pijshëm të kontaminuar, gjykimi u rihap në vitin 2012 dhe u shpall i pafajshëm. Referenca për sanksionin u hoq nga regjistri penal i aplikantit.

[Aktgjykimi final më](#)
[31/08/2011](#)

Për më tepër, për të parandaluar shkelje të ngjashme, në vitin 2011 u futën ndryshime në Kodin Penal. Këto ndryshime hoqën shpifjen dhe nocionin e fyerjes penale. Dekriminalizimi i tyre u krye në përputhje me dispozitat e dokumenteve evropiane, përfshirë Rezolutën 1577 (2007) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2016\)44](#)

Dekriminalizimi i fyerjes dhe shpifjes

*Rumani / Dalban
(28114/95)*

Pas vendimit të Gjykatës për një dënim penal për publikim të artikujve kritikë ndaj autoriteteve për veprimet e ndërmarra në ushtrimin e detyrave të tyre, Rregulloret e Emergjencave të vitit 2002 dhe Akti i vitit 2005 shfuqizuan dënimet me burgim për fyerje dhe shpifje.

[Aktgjykimi final më](#)
[28/09/1999](#)

Më pas, ligji i vitit 2006 dekriminalizoi fyerjen dhe shpifjen. Megjithatë, në janar 2007, Gjykata Kushtetuese e shpalli antikushtetues dekriminalizimin e fyerjes dhe shpifjes. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka krijuar njëfarë pasigurie juridike për efektet e dekriminalizimit. Për zbardhjen e kësaj çështjeje, Avokati i Shtetit u ankua në Gjykatën e Kasacionit. Në një vendim të vitit 2010, Gjykata e Kasacionit konfirmoi se pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese, fyerja dhe shpifja nuk janë më vepra penale. Ky vendim tani është i detyrueshëm në të gjitha gjykatat vendore. Kodi i ri Penal i vitit 2014 nuk e penalizon më fyerjen dhe shpifjen.

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2011\)73](#)

Dekriminalizimi i shpifjes

*Ukrainë / Marchenko
(4063/04)*

Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 10 në lidhje me dënimin e një nëpunësi civil për shpifje dhe një dënim me burgim me kusht për akuzën publike të eprorit të tij për përvetësim. Autoritetet kanë treguar se Kodi Penal i vitit 2001 nuk e klasifikon më shpifjen dhe fyerjen si vepra penale.

Në vitin 2009, Gjykata Supreme ndryshoi jurisprudencën e saj në lidhje me mbrojtjen e nderit, dinjitetit dhe reputacionit të një personi fizik ose juridik, duke konsideruar se rastet e shpifjes duhet të shqyrtohen në procedura civile.

[Aktajykimi final më](#)
[19/05/2009](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2019\)323](#)

7.3 Procedurat civile për dëmin në reputacion dhe të drejta të tjerëve

Zhvillimet legislative drejt mbrojtjes së lirisë së shprehjes më shumë në përputhje me Konventën Evropiane *Gjeorgji / Gorelishvili (12979/04)*

Procedurat civile për shpifje në vitet 2002 dhe 2003 kundër një zyrtari të lartë shtetëror dhe një politikani të njohur, çuan Gjykatën të deklaronte shkelje të nenit 10. Në momentin e ngjarjes, Kodi Civil i zbatueshëm nuk bën dallime ndërmjet deklaratave faktike dhe gjykimeve të vlerës, por i referohej në mënyrë uniforme "informacionit" dhe kërkonte që vërtetësia e çdo "informacioni" të provohej nga gazetari ose personi që e komunikon atë. Nga faktet e rastit në fjalë, kjo pjesë e Kodit Civil është ndryshuar dhe nuk i referohet më detyrimit të të pandehurit për të provuar informacionin që ai ose ajo komunikon.

[Aktajykimi final më](#)
[05/09/2007](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2010\)164](#)

Përveç kësaj, Akti për Lirinë e Fjalës dhe të Shprehjes i vitit 2004 zëvendësoi Aktin e Shtypit dhe Medias në fuqi në kohën e fakteve të këtij rasti. Akti e përcakton shpifjen si "*deklaratë që përmban fakte thelbësisht të rreme dhe që dëmton një individ, njollos emrin ose reputacionin e tij*". Ligji specifikon më tej se të gjithë, me përjashtim të zyrtarëve publikë, gëzojnë lirinë e shprehjes, e cila përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë e fjalës dhe debatit politik. Ai bën dallimin midis shpifjes së bërë ndaj një individi dhe shpifjes së bërë ndaj një personi publik. Kështu, në rastin e shpifjes së një personi publik, gazetari mban përgjegjësi civile vetëm nëse e dinte që fakti ishte i gabuar. Ligji parashikon që askush nuk mund të dënohet për shpifje nëse ai ose ajo nuk e dinte, ose nuk mund ta dinte, se deklaratat shpifëse po transmetoheshin ose do të transmetoheshin.

Miratimi i ligjit për median dhe shpifjen për të forcuar të drejtën e lirisë së shprehjes

Maltë / Falzon (45791/13)

Gjykatat civile për shpifje për shkrimin e artikujve që kritikojnë Parlamentin u konstatua se ishte në kundërshtim me nenin 10 nga Gjykata Evropiane. Për të parandaluar shkelje të ngjashme, Akti i ri për Median dhe Shpifjen i vitit 2018 shfuqizoi dhe zëvendësoi ligjin në fuqi në atë kohë, me synimin kryesor forcimin e së drejtës për lirinë e shprehjes. Përpara ardhjes së ligjit të ri, legjislativi nuk kishte përkufizim për 'shpifjen'. Sipas ligjit të ri, nocioni i 'dëmtimit të rëndë' të reputacionit të një personi është futur në përkufizimin e shpifjes, i cili renditet si "*komunikimi i një deklarate që dëmton seriozisht reputacionin e një personi dhe përfshin shpifje*".

[Aktajykimi final më](#)
[20/06/2018](#)

[Rezolutë finale](#)
[CM/ResDH\(2019\)122](#)

Për më tepër, veprimet penale për shpifje nuk janë më të mundshme dhe të gjitha procedurat penale që ishin në pritje para gjykatës në kohën e ardhjes së këtij ligji janë pushuar. Prandaj, paditë kundër shpifjes mund të ngrihen vetëm para gjykatave civile.

8. LIRIA E SHPREHJES DHE SIGURIA KOMBËTARE, SIGURA PUBLIKE DHE KUNDËR-TERRORIZMI

Amendamenti legjislativ për dënimin e akteve që prishin qetësinë publike dhe cenojnë dinjitetin njerëzor të viktimave të sistemeve totalitare *Hungari / Vajnai (33629/06)*

Pas vendimit të Gjykatës për dënimet penale të anëtarëve të një partie politike të majtë dhe konfiskimeve për veshjen e simbolit të yllit të kuq gjatë demonstratave paqësore dhe të organizuara ligjërisht, gjykimet u rihapën përpara Gjykatës Supreme, e cila rrëzoi aktgjykimet dhe shpalli pafajësinë. Si rezultat, dënimet u hoqën nga regjistri penal.

[Aktgjykimi final më 08/10/2008](#)

[Rezolutë finale CM/ResDH\(2019\)346](#)

Në momentin e ngjarjeve, shpërndarja ose përdorimi publik i një svastika, distinktivi SS, shigjeta kryq, simboli drapër dhe çekiç ose ylli i kuq ishin vepra të dënueshme me gjobë në Kodin Penal. Në shkurt 2013, Gjykata Kushtetuese e anuloi këtë dispozitë dhe Kodi Penal u ndryshua në prill 2013. Amendamenti përcakton se përhapja ose përdorimi i simboleve të sipërpërmendura duhet të supozohet se mund të prishë qetësinë publike dhe të ofendojë dinjitetin njerëzor të viktimave të sistemeve totalitare ose respektin për të vdekurit. Kështu, ndalimi nuk e penalizon më "thjeshtë shfaqjen" e një simboli të Yllit të Kuq në një mënyrë "pa dallim". Kështu, ndalimi bën të mundur përjashtimin nga fusha e zbatimit të veprimtarive dhe ideve që i përkasin qartë atyre të mbrojtura nga neni 10 i Konventës.

Shfuqizimi i një neni të legjislacionit kundër terrorizmit

Turqi / Arslan (23462/94)

Gjykata Evropiane shqyrtoi dënimet penale nga Gjykatat e Sigurimit të Shtetit në bazë të Aktit Anti-Terrorizëm në lidhje me publikimin e artikujve dhe librave dhe përgatitjen e mesazheve drejtuar publikut që konsideroheshin terroriste si propagandë. Seksioni 8 i Ligjit Anti-Terrorizëm i zbatueshëm në atë kohë dënonte propagandën për terrorizëm nëpërmjet materialit të shkruar, librave ose shtypit. Si pasojë e vendimit të Gjykatës Evropiane, neni 8 i ligjit kundër terrorizmit u shfuqizua me ligjin nr. 4928 të vitit 2003 dhe, për rrjedhojë, çdo përmendje e dënimeve penale në regjistrin penal u fshi. Akti i vitit 2003 synon të sjellë ligjin vendor në përputhje me kërkesat e Konventës.

[Aktgjykimi final më 08/07/1999](#)

[Rezolutë finale CM/ResDH\(2006\)79](#)

Amendamenti legjislativ në lidhje me lehtësimin e veprimtarisë së një bande ose një organizate të armatosur ilegale

Turqi / Emir (10054/03)

Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 10 në lidhje me një dënim, sipas zbatimit të ish-Kodit Penal, për "lehtësim të veprimtarisë së një bande apo organizate të armatosur" për shkak të publikimit në një revistë të një serie artikujsh që raportonin mbi ndërhyrjen e organeve ligjzbatuese në burgjet turke.

[Aktgjykimi final më 03/08/2007](#)

[Rezolutë finale CM/ResDH\(2009\)17](#)

Pas vendimit të Gjykatës Evropiane, dënimi u fshi nga regjistri penal. Për më tepër, për të parandaluar situata të ngjashme, ligji i vitit 2003 ndryshoi pjesërisht Kodin Penal duke fshirë referencën për "lehtësimin e veprimtarive të një bande ose një organizate të armatosur ilegale". Kjo referencë nuk figuron në Kodin e ri të Procedurës Penale, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2005.

Amendamenti që sqaron se shprehja e "keqdashjes" ose "armiqësisë midis komuniteteve të ndryshme" nuk konsiderohet "qëllim rebelimi". *Turqi / Foka (28940/95)*

[Aktgjykimi final më 26/01/2009](#)

[Rezolutë finale CM/ResDH\(2015\)153](#)

Në përgjigje ndaj konstatimeve të Gjykatës Evropiane për konfiskimin e kasetave, librave, fletoreve dhe kartave nga autoritetet, u morën masa për promovimin e lirisë së shprehjes. Në vitin 2007, pas fakteve të aktgjykimit, u fut një ndryshim në Kodin Penal, në mënyrë që nxitja e "ndjenjës së keqdashjes" dhe "armiqësisë midis komuniteteve të ndryshme" ose klasave të njerëzve të mos konsiderohen më "qëllim rebelimi".

Kështu, publikimi ose shpërndarja e fjalëve ose materialeve që nxisin keqdashje ndërmjet komuniteteve nuk do të konsiderohet më vepër sipas ligjit penal. Ky ndryshim do të sigurojë që çdo konfiskim i materialeve ose sendeve për arsye të ngjashme nuk do të ketë më bazë ligjore për qëllimet e nenit 10.

9. MARRJA E INFORMACIONIT DHE LIRIA E SHPREHJES E TË BURGOSURVE NË INSTITUCIONE PENALE

Amendamenti i Aktit për Ekzekutim të Dënimeve parashikon që sanksionet disiplinore nuk do t'u jepen të burgosurve për të bërë kërkesa ose ankesa

*Bullgari / Shahanov dhe
Palfreeman (35365/12)*

Pas sanksioneve të vendosura ndaj të burgosurve (përkatësisht 10 ditë izolim dhe 3 muaj heqje nga pako ushqimore) dhe të vendosura nga autoritetet e burgut në përgjigje ndaj ankesave ndaj punonjësve të burgut, autoritetet bënë me dije se kishin marrë masa pas ngjarjes. Sanksionet e vendosura janë autorizuar nga ligji në fuqi në kohën e ngjarjeve si "deklarata shpifëse ose pretendime të rreme kundër zyrtarëve të burgut".

[Aktajykimi final më
21/10/2016](#)

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2017\)256](#)

Ky ligj i vitit 2009 për ekzekutimin e dënimeve dhe paraburgimit u ndryshua në vitin 2013. Amendamenti parashikon që të burgosurit nuk duhet të disiplinohen nëse kërkojnë apo ankohen për diçka. Tashmë, dhuna fizike apo kërcënimet me dhunë ndaj kolegëve të burgosur apo punonjësve të burgut vazhdojnë të jenë shkelje disiplinore brenda burgut, por nuk përmenden deklarata shpifëse apo pretendime të rreme ndaj punonjësve të burgut apo të burgosurve të tjerë si bazë për vendosjen e sanksionit disiplinor. Prandaj, sanksionet disiplinore tani mund të shqiptohen vetëm në situata që nuk lidhen me ankesat e mëparshme.

Amendamenti i Aktit të Burgimit për të lehtësuar qasjen në uebsajte në burgje

*Estoni / Kalda
(17429/10)*

Në vitin 2019, autoritetet ndryshuan seksionin e Aktit të Burgimit që ndalonte qasjen në uebsajtet në burg, përveç faqeve specifike të dedikuara për të dhënat legjislative dhe gjyqësore. Amendamenti u lejon të burgosurve të qasjen në uebsajtet në fjalë në këtë rast, duke përfshirë Kancelarin e Drejtësisë dhe Këshillin e Evropës në Talin (*Uebsajti i Riigikogu-t*). Megjithatë, autoritetet kanë informuar se faqet duhet të rregullohen për të bllokuar qasjen në linqet të tjera që mbeten të ndaluara.

[Aktajykimi final më
06/06/2016](#)

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2019\)109](#)

Legjislacioni i ri për të përmirësuar qasjen në uebsajte në burgje

*Lituani / Jankovskis
(21575/08)*

Në vitin 2014, qasja në një sërë uebsajtesh iu dha të burgosurve në institucionet penale përmes Qasjes së Kufizuar në Internet (LIA). Për të garantuar zbatimin uniform të LIA-s në të gjitha institucionet e vuajtjes së dënimit, Shërbimi i Burgjeve ka nxjerrë udhëzimin e LIA-s për të burgosurit dhe të dënuarit. Në këto udhëzime parashikohet që çdo objekt të kishte një përshkrim të procedurës së përdorimit të internetit, një listë të uebsajteve të qasshme dhe të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve të LIA-s. Si rezultat i rekomandimeve të dhëna, burgjet miratuan rregullat e përdorimit të qasjes në internet.

[Aktajykimi final më
17/04/2017](#)

[Rezolutë finale
CM/ResDH\(2019\)73](#)

Në vitin 2017, një urdhër miratoi procedurën me shkrim për përdorimin e LIA-s, duke specifikuar që të sigurohen kushte të barabarta qasjeje për të gjithë. Kështu, një i paraburgosur ose i burgosur që dëshiron të ketë qasje në LIA duhet t'i paraqesë kërkesë drejtuesit të njësisë së tij/saj. Duke marrë parasysh uebsajtet e kërkuara më shpesh nga të paraburgosurit, janë autorizuar 21 uebsajte të tjera. Lista nuk është e plotë dhe të paraburgosurit mund të vazhdojnë të kërkojnë qasje në uebsajte të tjera.

INDEKSI I RASTEVE

<i>Armeni / Meltex dhe Mesrop Movsesyan</i>	9
<i>Austri / Informationsverein Lentia dhe të tjerët</i>	9
<i>Belgjikë / Ernst dhe të tjerë</i>	7
<i>Bullgari / Glas Nadezhda EOOD dhe Anatoliy Elenkov</i>	9
<i>Bullgari / Raichinov</i>	14
<i>Bullgari / Shahanov dhe Palfreeman</i>	21
<i>KRO / Slava Jurishiq</i>	16
<i>Spanjë / Otegi Mondragon</i>	14
<i>Spanjë / Rodriguez Ravelo</i>	14
<i>Estoni / Kalda</i>	21
<i>Finlandë / Nikula</i>	15
<i>Francë / Du Roy dhe Malaurie</i>	15
<i>Francë / Eon</i>	15
<i>Francë / Jean-Jacques Morel Group</i>	15
<i>Francë / Mamère</i>	16
<i>Gjeorgji / Gorelishvili</i>	18
<i>Hungari / Vajnai</i>	19
<i>Itali / Centro Europa 7 S.R.L. dhe Di Stefano</i>	10
<i>Lituani / Jankovskis</i>	21
<i>Lituani / Sekmadienis Ltd</i>	11
<i>Luksemburg / Roemen dhe Schmit</i>	7
<i>Maqedoni / Makraduli</i>	17
<i>Maltë / Falzon</i>	18
<i>Maltë / Unifaun Theatre Productions Limited dhe të tjerët</i>	
11	
<i>Mal i Zi / Shabanoviq</i>	17
<i>Holandë / Telegraaf Media Nederland Landelijke Media b.v. dhe të tjerët</i>	8
<i>Holandë / Voskuil</i>	7
<i>Norvegji / Becker</i>	8
<i>Norvegji / Tønsbergs Blad AS dhe Haukom</i>	4
<i>Norvegji / TV Vest As dhe Rogaland Pensjonistparti</i>	12
<i>Poloni / Wizerkaniuk</i>	4
<i>Portugali / Colaço Mestre dhe Sociedade Independente de Comunicação</i>	5
<i>Portugali / Medipress-Sociedade Jornalística e Editorial, Lda</i>	4
<i>Rumani / Dalban</i>	17
<i>Serbi / Lepojiq dhe Filipoviq</i>	16
<i>Sloveni / Mladina d.d. Lubjanë</i>	5
<i>Turqi / Arslan</i>	19
<i>Turqi / Emir</i>	19
<i>Turqi / Erdoğan Gökçe</i>	12
<i>Turqi / Foka</i>	20
<i>Turqi / Saygılı dhe Bilgiç</i>	5
<i>Mbretëri e Bashkuar / Bowman</i>	12
<i>Ukrainë / Gongadze</i>	3
<i>Ukrainë / Marchenko</i>	17
<i>Ukrainë / Ukrainian Media Group</i>	6

Ky përkthim është prodhuar duke përdorur fondet e Programit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022, projekti "Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave në Kosovë (JUFREX)". Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë mënyrë që pasqyrojnë mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian.

Përkthimi është
bashkë financuar nga
Bashkimi Evropian

